

BASHKIA DEVOLL
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Për marrjen me qira nga ana e Bashkisë Devoll të pasurisë së paluajtshme truall/are nga të tretë, me sipërfaqe rreth 3000 m² për nevoja të stacionimit të mjeteve të Bashkisë Devoll.

Bashkia Devoll kërkon të marrë me qira pasuri të paluajtshme truall/arë me qëllimin për të plotësuar nevojën për të garantuar ambient të përshtatshëm dhe të sigurtë për vendqëndrim (parkimin) dhe mirëmbajtjen e mjeteve të ndryshme të Bashkisë Devoll, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

a) Sipërfaqja e trullit/ ares duhet të jetë me hapësirë të përshtatshme jo më pak se 3000m².

b) Pasuria truall/are që do të merret me qira duhet të ketë vendndodhjen në territorin e qytetit të Bilishtit dhe në një reze rreth 1000 m larg nga Bashkia Devoll.

c) Pasuria truall/ are që do të merret me qira, duhet të ketë akses hyrje/dalje në rrjetin rrugor ekzistues.

ç) Pasuria duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet për parkimin, qëndrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të Bashkisë Devoll.

d) Pasuria truall/are duhet të jetë e rrethuar sipas të gjitha standardeve më të mira teknike, në mënyrë që të garantojnë sigurinë dhe ruajtjen e mjeteve që do të parkohen brenda territorit të kësaj pasurie,

dh) Pasuria truall/ are që do të merret me qira duhet të jetë e regjistruar me Certifikatë Pronësie dhe hartë treguese, nga ASHK.

e) Afati i kontratës së qiradhënies do të jetë deri në 5 (pese) vjet.

II. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

1 - Kërkesë e ofertuesit për pjesëmarrje në konkurrim.

2-Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës.

3- Prona duhet të jetë e lirë dhe pa barrë hiptoekore gjatë gjithë procesit të konkurimit dhe deri në nënshkrimin e kontratës në rast të shpalljes fitues.

4- Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera (në rast se ka kontratë të furnizimit të energjisë elektrike për pasurinë).

5- Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera (në rast se ka kontratë të furnizimit nga Ujësjellës-kanalizime).

6- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.

7- Nëse pronari është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:

a- NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe Ekstrat Historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.

b- Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.

c- Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime.

d- Vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale si dhe nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin.

8- Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe kërkesave specifike të ambienteve që kërkohen nga Bashkia Devoll.

9- Kopje ID e titullarit të pronës (në rast se është individ).

10- Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH.

11-Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë për vlerën e detyrimit mujor të qirasë (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i pasurisë së paluajtshme).

12 – Vlera limit për konkurrim është 95,000 lekë / muaj. Ofertuesit nuk duhet të japin ofertë mujore me vlerë më të lartë se vlera limit e përcaktuar në këtë pikë. Ofertat më të larta se vlera limit e përcaktuar në këtë pikë nuk do të pranohen dhe do të skualifikohen.

Në vlerën e ofruar nga ofertuesi përfshihen të gjitha taksat, tatimet apo cdo detyrim tjetër ndaj institucioneve në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira, nëngarkim të qiradhënesit.

13- Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin mujor më të ulët (oferta ekonomikisht më e favorshme) e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen me qira.

14- Në ofertën e tij subjekti i interesuar, duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit.

15- Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

III. Paraqitja e dokumentave dhe ofertës së qirasë të pasurisë së paluajtshme truall/are :

Dorëzimi i dokumentave dhe ofertës ekonomike nga subjektet e interesuar, duhet të bëhet brenda datës 18.11.2024, ora 16:00, me postë ose dorazi pranë institucionit të Bashkisë Devoll, në adresën: Bashkia Devoll, Rruga “24 Tetor” Lagjja Nr. 1, Bilisht

Për çdo komunikim apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike: bashkiadevoll@gmail.com